




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

Seria 5: Statistikat Sociale

Anketa e buxhetit të ekonomive familjare 2009



Prishtinë
2010



ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

Seria 5: Statistikat Sociale

Anketa e buxhetit të ekonomive familjare 2009



ENTI I STATIKËS SË KOSOVËS
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Qershor 2010

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: www.ks-gov.net/esk

Parathënie

Enti Statistikor i Kosovës (ESK), përkatësisht Departamenti i Statistikave Sociale (DSS) është duke zhvilluar Anketën mbi buxhetin e ekonomive familjare (ABEF), prej vitit 2002.

Qëllimi i publikimit të rezultateve të Anketës së buxhetit të ekonomive familjare 2009, është që të ofrojmë të dhëna statistikore lidhur me të ardhurat, konsumin si dhe të dhëna statistikore për çështjet tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me standardin jetësor të ekonomive familjare në Kosovë.

Në këtë publikim janë paraqitur rezultatet në formë përmbledhëse për konsumin, shpenzimet dhe të ardhurat e ekonomive familjare për periudhat 2007 - 2009.

Përmes këtij publikimi është synuar zbutja e mungesës së informacioneve në fushën e standardit jetësor të ekonomive familjare në Kosovë. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si një bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore.

Përkrahje profesionale për zhvillimin e ABEF, kanë ofruar Organizata Suedeze (SIDA) dhe Banka Botërore (BB). Për mbështetje profesionale të këtij publikimi veçanërisht falënderojmë ekspertin e organizatës Suedeze SIDA Lars Lundgren si dhe ekspertet nga Banka Botërore Sachiko Miyata dhe Ardiana Gashi.

Nga stafi tjetër i ESK-së, në nivel rajonal falënderojmë punëtorët e zyrave rajonale që kanë kontribuar në grumbullimin e të dhënave të ABEF .

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: social@ks-gov.net.

Publikim përgatitën:

1. Mr. sc. Bashkim Bellaqa – Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,
2. Emine Deliu – Shefe e Sektorit të Standardit Jetësor
3. Bekim Canilli – Shef i Divizionit të Metodologjisë,
4. Besa Haqifi – Zyrtare e lartë e Sektorit të Standardit Jetësor,
5. Hatixhe Januzaj - Zyrtare e Sektorit të Standardit Jetësor,
6. Mevlyde Dehari - Zyrtare e Sektorit të Standardit Jetësor dhe
7. Ahmet Cakolli - Zyrtar për dizajnim

Qershor, 2010

u.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,
Prof. Dr. Nait Vrenezi

Lista e shkurtesave

ABEF	-	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
BB	-	Banka Botërore
BE	-	Bashkimi Evropian
DSS	-	Departamenti i Statistikave Sociale
ESK	-	Enti i Statistikës së Kosovës
IÇK	-	Indeksi i Çmimeve Konsumuese
KKIQ	-	Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit
LLK	-	Llogaritë Kombëtare
SIDA	-	Agjencioni Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Bashkëpunim

P ë r m b a j t j a

	Faqe
HYRJE	5
1 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2007 - 2009	6
1.1. Trendët e konsumit	6
1.2. Shpërndarja e konsumit sipas grupeve të konsumit	6
2 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2007-2009	8
2.1 Konsumi kryesor (pesë grupet më të mëdha)	9
2.2 Ushqimi dhe pijet joalkoolike	9
2.3 Banimi	10
2.4 Transporti	11
2.5 Veshmbathjet	11
2.6 Alkooli dhe duhani	12
2.7 Mobiliet	13
2.8 Shëndetësia	13
2.9 Komunikimi	14
2.10 Rekreacioni	14
2.11 Arsimi	15
2.12 Hotele dhe restorante	15
2.13 Mallrat dhe shërbime të tjera	16
2.14 Konkluzion	16
3 Të hyrat private në Kosovë 2007 - 2009	19
3.1. Të hyrat kryesore të ekonomive familjare.....	19
3.2 Burimet e të hyrave individuale	20
3.3 Të ardhurat sipas strukturës gjinore	22
4 Pronësia sipas strukturës gjinore	22
Tabela 1: Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2007 – 2009	6
Tabela 2: Shpërndarja e konsumit në Kosovë sipas grupeve të konsumit	7
Tabela 3: Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë 2007-2009 në %	7
Tabela 4: Përqindja e duhanpirësve në popullatë në vitin 2008 sipas gjinisë dhe konsumit ditor të cigareve, % e popullatës në moshën 10 vjeçare dhe më të moshuara	12
Tabela 5: Konsumi vjetor i ekonomive shtëpiake në Kosovë 2007-2009 sipas konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, € dhe % konsumit të përgjithshëm	17
Tabela 6: Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë, % e ekonomive familjare ...	19
Tabela 7: Burimet e të hyrave individuale në Kosovë, viti 2009, % e të hyrave.....	20
Tabela 8: Burimet e të hyrave sipas nivelit më të lartë të arsimimit, viti 2009 (%)	21
Tabela 9: Të ardhurat mesatare sipas gjinisë për individë me punësim 12 mujor, në €.....	22
Tabela 10: Pronësia në vitin 2009 sipas gjinisë, në %	22
Graf. 1: Konsumi i përgjithshëm vjetor i ekonomive shtëpiake sipas lokalitetit 2007-2009	8
Graf. 2: Pesë kategoritë kryesore të konsumit të ekonomive familjare sipas lokalitetit, % e përgjithshme 2007-2009	9
Graf. 3: Konsumi vjetor i ushqimit dhe pijeve joalkoolike nga ekonomitë familjare sipas lokalitetit 2007-2009 në €.....	9
Graf. 4: Pjesëmarrja e ushqimit dhe pijeve joalkoolike në konsumin e përgjithshëm sipas lokalitetit 2007-2009 në %	10
Graf. 5: Shpenzimet për banim të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007-2009 në €.....	10
Graf. 6: Shpenzimet e transportit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007-2009 në €.....	11
Graf. 7: Shpenzimet për veshmbathje të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007-2009 në €.....	11
Graf. 8: Konsumi i Alkoolit dhe duhanit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007-2009, në €.....	12
Graf. 9: Mobiliet sipas lokalitetit 2007-2009 në €	13
Graf. 10: Shpenzimet për shëndetësi të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007-2009, në €.....	13
Graf. 11: Shpenzimet e komunikimit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007-2009, në €.....	14
Graf. 12: Shpenzimet për rekreacion sipas lokalitetit 2007-2009, në €.....	14
Graf. 13: Shpenzimet për arsim të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007-2009, në €.....	15
Graf. 14: Shpenzimet për hotele dhe restorante të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007-2009, në €...	15
Graf. 15: Shpenzimet tjera të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007-2009, në €.....	16

H Y R J E

ABEF është një vrojtim statistikor që kryhet për të marrë të dhëna mbi shpenzimet për konsum, vetëkonsum, të ardhurat e familjeve dhe kushtet bazë socio-ekonomike në të cilin familjet jetojnë. Anketa siguron gjithashtu të dhëna mbi disa tregues të rëndësishëm në lidhje me kushtet e jetesës (banimin, posedimin e pajisjeve afatgjata në familje, kushtet e ngrohjes, udhëtimet dhe/ose pushimet vjetore), si edhe të dhëna mbi karakteristikat bazë demografike, ekonomike dhe sociale të familjeve.

Të dhënat e mbledhura nga ABEF do të sigurojnë gjithashtu informacion mbi nivelin e jetesës, masën dhe përbërjen e shpenzimeve dhe konsumit total të familjeve dhe karakteristika socio-ekonomike të tyre. Një nga objektivat specifike të Anketës së Buxhetit të Familjes është marrja e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e peshave të cilat përdoren për llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit. Gjithashtu, kjo anketë siguron të dhëna që do të përdoren si një input për matjen e konsumit privat në Llogaritë Kombëtare (LLK) të familjeve si dhe për analizimin e mirëqenies dhe varfërisë në nivel vendi brenda periudhës kohore të përcaktuar.

Të dhënat janë mbledhur në tërë Kosovën gjatë një viti duke përfshirë 2.400 ekonomi familjare, të zgjedhura sipas metodës së rastit dhe në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare. Shkalla e përgjigjeve është rreth 80 përqind nëse ekonomitë familjare të zëvendësuar janë konsideruar se nuk kanë dhënë përgjigje.

Progresi ekonomik në vitet e fundit do të definohej si përmirësim i kushteve të jetesës në krahasim me periudhën menjëherë pas luftës. Në këto rrethana, ABEF është e mirëseardhur për matjen e standardit jetësor, për ofrimin e të dhënave për Bruto Produktin Vendor (BPV) si dhe fitimin e ponderave të çmimeve konsumuese.

Mostra e ABEF ka shtrirje në zonat urbane dhe rurale, në tërë territorin e Kosovës. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave është bërë përmes programeve ACCESS dhe SPSS. Pyetësi përmbante informata mbi përbërjen demografike të ekonomisë familjare duke përfshirë të dhëna individuale për secilin anëtar të ekonomisë familjare, si dhe të ardhurat, konsumin dhe shpenzimet, kushtet e banimit, aktivitete në biznese dhe bujqësi, qasjen në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet publike, etj.

1 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2007 - 2009

Ky publikim paraqet të dhënat makroekonomike të ABEF për vitin 2007 - 2009. Në disa raste rezultatet ndryshojnë nga Llogaritë Kombëtare (LLK-të), pasi që LLK-të plotësohen më disa burime tjera të të dhënave (si p.sh. të dhëna prej doganave, të dhëna nga importi dhe të dhëna tjera nga prodhimi vendor) dhe bëjnë disa përshtatje.

Të dhënat janë grumbulluar sipas standardit ndërkombëtar të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ). Më një mostër paksa më të vogël rezultatet duhet të konsiderohen si të përafërta. Pa një regjistrim të ri të përgjithshëm të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është vështirë që të bëhet ndonjë vlerësim.

1.1. Trendët e konsumit

Sipas rezultateve të ABEF 2009, vërehet një rritje prej 6 përqind të konsumit të përgjithshëm krahasuar me vitin 2008, ndërsa te konsumi për ekonomitë familjare një rritje prej vetëm 2 përqind. Konsumi për kokë banori në vitin 2009 ka qenë pothuajse njësoj si në vitin 2008.

Tabela 1: Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2007 – 2009

Viti	Gjithsej në Milion €	Konsumi për ekonomi familjare €	Konsumi për banor €
2007	1. 413	5. 700	980
2008	1. 798	6. 707	1.156
2009	1. 911	6. 847	1.160

1.2. Shpërndarja e konsumit sipas grupeve të konsumit

Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare në vitin 2009 është shpenzuar në ushqim dhe banim, nga 36 përqind të konsumit të përgjithshëm. Për transport dhe veshmbathje ekonomitë familjare kanë shpenzuar nga 5 përqind.

Në vitin 2009 rreth 7 përqind e konsumit të përgjithshëm përfshinë ushqimin nga prodhimi vetanak.

Tabela 2: Shpërndarja e konsumit në Kosovë sipas grupeve të konsumit 2007 - 2009 në %

Konsumi	2007	2008	2009
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	39	38	36
Alkool dhe duhan	4	3	3
Veshmbathja	5	5	5
Banimi	31	35	36
Mobiliet	4	3	3
Shëndetësi	3	2	3
Transport	5	5	5
Komunikim	2	2	2
Rekreacion	1	1	2
Edukim	1	1	1
Hotel dhe restorante	2	2	1
Të tjera	3	3	3
Gjithsej	100	100	100
<i>Ushqimi i vet-prodhuar nga ekonomitë familjare</i>	8	8	7

Ushqimi në Kosovë dominohet nga qumështi, djathi, vezët, pastaj nga buka dhe drithërat, mishi, që kontribuojnë më shumë se gjysmën e konsumit të ushqimit (në vlerë). Më pas radhiten perimet dhe pijet jo alkoolike.

Tabela 3: Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë 2007- 2009 në %

Konsumi	2007	2008	2009
Buka dhe drithërat	21	22	19
Mishi	19	18	18
Peshku	1	1	1
Qumshti, djathi, vezët	21	20	20
Vajrat dhe yndyrat	5	5	4
Frutat	6	6	7
Perimet	11	12	12
Sheqeri dhe ëmbëlsirat	5	4	5
Produkte tjera ushqimore	4	4	5
Pijet joalkoolike	7	8	9
Ushqimi i përgjithshëm	100	100	100

2 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2007–2009

Dihet se konsumi është pjesë e rëndësishme e jetës së popullatës, pra niveli i konsumit dhe përmasat e tij janë qenësore për mirëqenien, ndërsa pasuria dhe varfëria varen nga aspekte të tjera në jetë. Të dhënat për konsum merren nga ekonomitë familjare, përderisa të ardhurat fitohen nga individët. Alkooli dhe duhani, veshmbathjet, argëtimi dhe disa gjëra tjera specifike mund të konsumohen individualisht, por pjesa më e madhe, si ushqimi, banimi dhe furnizimi shfrytëzohen së bashku nga pjesëtarët e ekonomive familjare.

Konsumi klasifikohet sipas Standardit të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ) në harmonizim me Llogaritë Kombëtare dhe Indeksin e Çmimeve të Konsumit. Përveç disa përmirësimeve, standarde të njëjta janë aplikuar gjatë viteve, duke e bërë atë të krahasueshëm më lehtë gjatë kohës.

Shumica e konsumit bazohet në mallrat e blera dhe shërbimet e paguara gjatë periudhës së referuar, dhe një pjesë më e vogël në mallrat të vetëprodhuara. Periudha e referuar është një muaj për konsumin ditor (të mbështetur me mbajtjen e shënimeve) dhe 12 muajt e fundit për mallrat e qëndrueshme.


Në këtë dokument ne do të fokusohemi në nivelin e konsumit për grupe të ndryshme të konsumit (ushqim, veshmbathje, banim, etj.) dhe pjesëmarrjen e tyre në konsumin e përgjithshëm. Ekonomitë familjare me arsim të lartë dhe ekonomitë familjare urbane mund të shihen si treguese për zhvillimin e ardhshëm të konsumit, pasi që gjithnjë e më shumë njerëzit po arsimohen dhe Kosova është duke u urbanizuar.

Shifrat në tekst janë rumbullakuar që të sinjalizojnë se një mostër anketë mund t'i japë vetëm vlera të përafërta.

Konsumi për ekonomi familjare gjatë vitit 2009 në Kosovë ka qenë 6.847 €, nga kjo vërehet se ka pasur rritje prej vetëm 2 përqind në krahasim me vitin 2008.

Në ekonomitë familjare në vendbanime urbane rritje e konsumit ka qenë rreth 8 përqind, por te ekonomitë familjare në vendbanime rurale është vërejtur një rënie rreth 2 përqind.


Graf. 1: Konsumi i përgjithshëm vjetor i ekonomive shtëpiake sipas lokalitetit 2007- 2009



2.1 Konsumi kryesor (pesë grupet më të mëdha)

Pesë kategoritë kryesore të konsumit më të lartë (ushqimi, banimi, transporti, veshmbathjet, si dhe alkooli dhe duhani) paraqesin 85 përqind të konsumit të përgjithshëm. Shtatë kategoritë tjera të konsumit e ndajnë 15 përqind të konsumit.


Graf. 2: Pesë kategoritë kryesore të konsumit të ekonomive familjare sipas lokalitetit, % e përgjithshme 2007- 2009



2.2 Ushqimi dhe pijet joalkoolike


Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare shfrytëzohet për ushqim dhe pijet joalkoolike dhe është llogaritur 2.442 € për vitin 2009 apo 36 përqind të konsumit të përgjithshëm. Shpenzimet për ushqim dhe pijet joalkoolike në ekonomitë familjare paraqesin rënie prej 5 përqind krahasuar me vitin 2008. Kjo pjesëmarrje më e vogël e buxhetit e shpenzuar për ushqim dhe pijet joalkoolike tregon një mirëqenie më të lartë.

Graf. 3: Konsumi vjetor i ushqimit dhe pijeve joalkoolike nga ekonomitë familjare sipas lokalitetit 2007- 2009 në €



Të dhënat e paraqitura në figurën 4 tregojnë se ushqimi dhe pijet joalkoolike përbëjnë komponentin kryesor të konsumit. Në Kosovë pjesëmarrja e ushqimit dhe pijeve joalkoolike në konsum është zvogëluar nga 38 përqind të vitit 2008 në 36 përqind në vitin 2009. Trendi i rënies është paraqitur si në zona urbane ashtu edhe në zona rurale.

Graf. 4: Pjesëmarrja e ushqimit dhe pijeve joalkoolike në konsumin e përgjithshëm sipas lokalitetit 2007- 2009 në %




2.3 Banimi

Banimi përbën pjesën e dytë më të madhe të buxhetit të ekonomive familjare me 2. 432 € apo 36 përqind të buxhetit të ekonomive familjare, që paraqet rritje prej 5 përqind krahasuar me vitin 2008. Pjesa e buxhetit e cila është ndarë për banim ndryshon sipas lokalitetit dhe ato -12 përqind për ekonomitë familjare rurale, dhe 24 përqind për ato urbane.

Pjesa më e madhe e banimit është "qiraja e vlerësuar". Një pjesë e vogël e ekonomive familjare paguajnë qira.

Ushqimi dhe pijet joalkoolike dhe banimi së bashku përbëjnë më shumë se dy të tretat apo 72 përqind të buxhetit të ekonomive familjare.


Graf. 5: Shpenzimet për banim të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007- 2009 në €



2.4 Transporti

Transporti në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 ka pasur pothuajse të njejtin trend (ritje prej 0,8 përqind). Pjesa e buxhetit e ndarë për transport në vitin 2009 ka qenë 4 përqind për ekonomitë familjare urbane ndërsa 6 përqind për ato rurale.


Graf. 6: Shpenzimet e transportit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007- 2009 në €



2.5 Veshmbathjet

Një ekonomi familjare në vitin 2009 mesatarisht ka shpenzuar rreth 300 € për veshmbathje apo 5 përqind (%) të buxhetit, që paraqet ritje prej rreth 15 përqind në krahasim me vitin 2008 dhe ato në vendbanime urbane ritje prej 20 përqind e në rurale 10 përqind.

Graf. 7: Shpenzimet për veshmbathje të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007- 2009 në €



2.6 Alkooli dhe duhani

Në buxhetin e përgjithshëm të ekonomisë familjare në vitin 2009 alkooli dhe duhani marrin pjesë rreth 3 përqind, apo 231 € në vit. Është evidente rritja e shpenzimeve për konsum të alkoolit dhe duhanit në krahasim me vitet 2008 dhe 2007. Rritja në vitin 2009 ka qenë 13 përqind në Kosovë, në vendbanime urbane është më e theksuar, 18 përqind, kurse në rurale 9 përqind.

Graf. 8: Konsumi i Alkoolit dhe duhanit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007- 2009, në €





Tabela 4: Përqindja e duhanpirësve në popullatë në vitin 2009 sipas gjinisë dhe konsumit ditor të cigareve, % e popullatës në moshën 10 vjeçare dhe më të moshuara

Numri i cigareve	Meshkujt (%)		Femrat (%)		Të gjithë (%)	
	2008	2009	2008	2009	2008	2009
1 deri 10	2	2	2	2	2	2
11 deri 20	17	14	3	3	10	9
21+	4	3	0	0	2	1
Përqindja e duhanpirësve	23	19	5	5	14	12

2.7 Mobiliet

Gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009 ka pasur ndryshueshmëri në shpenzime për mobilie. Në vendbanime urbane vërehet rritje konstante rreth 3 përqind prej vitit në vit. Në vitin 2008 në Kosovë në përgjithësi dhe në vendbanime rurale ka pasur rritje të shpenzimeve. Në vitin 2009 ekonomitë familjare mesatarisht ka shpenzuar rreth 220 € në vit, apo rreth 3 përqind më pak krahasuar me vitin 2008.


Graf. 9: Mobiliet sipas lokalitetit 2007- 2009 në €



2.8 Shëndetësia

Shpenzimet për shëndetësi janë rritur prej vitit në vit. Në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 ka qenë rritje prej 16 përqind, dhe ato në vendbanime urbane 24 përqind e në rurale 9 përqind.


Graf.10: Shpenzimet për shëndetësi të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007- 2009, në €



2.9 Komunikimi

Shpenzimet për komunikim kanë pasur një oscilim (rritje-zbritje) të vogël qysh prej vitit 2006, por në vendbanime urbane rënia është konstante, edhe pse në vendbanime urbane dukshëm shpenzohet më shumë për komunikim sesa në vendbanime rurale. Shpenzimet për komunikim në përgjithësi në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 vërehet rënie dhe ato për 6 përqind.

Graf. 11: Shpenzimet e komunikimit të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007- 2009, në €




2.10 Rekreacioni

Niveli i shpenzimeve për rekreacion në të gjitha grupet e ekonomive familjare ka qenë më i lartë në vitin 2009, në krahasim me vitet 2007 dhe 2008.

Në vitin 2009 ekonomitë familjare në vendbanime urbane dukshëm kanë shpenzuar më shumë për rekreacion në krahasim me vitin 2008 dhe ato për 91 përqind. Në vendbanime rurale shpenzime për rekreacion shënojnë një rritje të vogël, por graduale, prej vitit në vit.


Graf. 12: Shpenzimet për rekreacion sipas lokalitetit 2007- 2009, në €



2.11 Arsimi

Shpenzimet për arsim kanë qenë më të ulëta në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 në të gjitha grupe të ekonomive familjare, sidomos në vendbanime rurale (rënie prej 42 përqind).


Graf. 13: Shpenzimet për arsim të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007- 2009, në €



2.12 Hotele dhe restorante

Në vitin 2009, shpenzimet për hotele dhe restorante kanë shënuar një rritje të dukshme në të gjitha grupe të ekonomive familjare, sidomos në vendbanime urbane (ritje prej 92 përqind).


Graf. 14: Shpenzimet për hotele dhe restorante të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007- 2009, në €



2.13 Mallrat dhe shërbime të tjera

Ky grup është një përzierje e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për rregullim të flokëve, mallra për nevoja personale, shpenzime për sigurime dhe shpenzime tjera financiare. Ekonomitë familjare në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 kanë pasur një rritje të vogël të shpenzimeve prej 3 përqind. Në vendbanime urbane shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera në vite 2007 dhe 2008 kanë qenë pothuajse të njëjta, por në vitin 2009 shënohet rritje prej 11 përqind. Në vendbanime rurale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 vërehet dukshëm rënie, 35 përqind.

Graf. 15: Shpenzimet tjera të ekonomive familjare sipas lokalitetit 2007- 2009, në €



2.14 Konkluzion

Ekonomia familjare kosovare ngadalë po transformohet nga dominimi i ushqimit në banim, veshmbathje dhe transport. Ekonomitë familjare urbane dhe ato me arsim të lartë janë më përpara në këtë aspekt dhe po e rrisin pjesën e buxhetit edhe për rekreacion, hotele dhe restorante, shëndetësi etj.

Tabela 5: Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë 2007- 2009, sipas 5 grupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, në %

Vitet	Ushqimi	Alkool dhe duhan	Veshmbathje	Banim	Mobilje	Shëndetësi	Transport	Komunikim	Rekreatcion	Arsim	Hotele dhe restau-rante	Të tjera	Totali €
Kosovë													
2007	2 282	206	296	1 833	210	145	285	111	69	36	103	145	5 721
2008	2 581	205	309	2 324	227	152	358	114	73	75	111	178	6 707
2009	2 442	231	354	2 432	221	176	361	107	106	47	188	183	6 847
Urbane													
2007	2 144	210	281	2 286	198	136	262	147	77	29	171	173	6 144
2008	2 399	204	283	2 388	214	142	331	138	81	87	152	174	6 894
2009	2 344	241	340	2 967	223	176	310	126	155	60	292	193	7 429
Rurale													
2007	2 384	202	307	1 503	219	152	303	85	63	40	53	125	5 436
2008	2 744	205	332	1 997	238	161	382	91	66	64	73	181	6 536
2009	2 512	223	364	2 045	220	175	398	93	70	37	112	117	6 426
Kryefamiljari me arsim fillor apo më pak													
2007	2 199	207	283	1 695	226	155	233	89	58	43	52	140	5 380
2008	2 437	220	298	1 987	202	142	308	93	53	39	59	150	5 986
2009	2 279	216	319	2 126	198	154	322	89	56	23	84	148	6 013
Kryefamiljari me arsim të mesëm													
2007	2 297	210	301	1 835	199	133	294	112	63	27	109	138	5 718
2008	2 572	200	300	2 393	232	146	388	118	73	72	118	179	6 789
2009	2 409	230	352	2 417	220	143	367	103	104	48	160	199	6 752
Kryefamiljari me arsim të lartë													
2007	2 542	160	373	2 730	228	135	395	192	123	58	314	222	7 472
2008	2 910	164	426	3 309	245	162	417	188	130	185	303	216	8 656
2009	3 133	263	570	3 764	312	271	526	201	352	140	821	274	10 625

Tabela 5: Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë 2007- 2009, sipas 5 grupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, në % (vazhdim)

Vitet	Ushqimi	Alkool dhe duhan	Veshmbathje	Banim	Mobilje	Shëndetësi	Transport	Komunikim	Rekreacion	Arsim	Hotele dhe restorante	Të tjera	5 grupet kryesore ¹ %
Kosovë													
2007	40%	4%	5%	32%	4%	3%	5%	2%	1%	1%	2%	3%	86%
2008	38%	3%	5%	35%	3%	2%	5%	2%	1%	1%	2%	3%	86%
2009	36%	3%	5%	36%	3%	3%	5%	2%	2%	1%	1%	3%	85%
Urbane													
2007	35%	3%	5%	37%	3%	2%	4%	2%	1%	0%	3%	3%	84%
2008	35%	3%	4%	39%	3%	2%	5%	2%	1%	1%	2%	3%	86%
2009	32%	3%	5%	40%	3%	2%	4%	2%	2%	1%	4%	3%	84%
Rurale													
2007	44%	4%	6%	28%	4%	3%	6%	2%	1%	1%	1%	2%	88%
2008	42%	3%	5%	31%	4%	2%	6%	1%	1%	1%	1%	3%	88%
2009	39%	3%	6%	32%	3%	3%	6%	1%	1%	1%	2%	3%	86%
Kryefamiljari me arsim fillor apo më pak													
2007	41%	9%	5%	32%	4%	3%	4%	2%	1%	1%	1%	3%	86%
2008	41%	4%	5%	33%	3%	2%	5%	2%	1%	1%	1%	2%	87%
2009	38%	4%	5%	35%	3%	3%	5%	1%	1%	0%	1%	2%	87%
Kryefamiljari me arsim të mesëm													
2007	40%	4%	5%	32%	3%	2%	5%	2%	1%	0%	2%	2%	85%
2008	38%	3%	4%	35%	3%	2%	6%	2%	1%	1%	2%	3%	86%
2009	36%	3%	5%	36%	3%	2%	5%	2%	2%	1%	2%	3%	85%
Kryefamiljari me arsim të lartë													
2007	34%	2%	5%	37%	3%	2%	5%	3%	2%	1%	4%	3%	84%
2008	34%	2%	5%	38%	3%	2%	5%	2%	2%	2%	3%	2%	85%
2009	29%	2%	5%	35%	3%	3%	5%	2%	3%	1%	8%	3%	76%

¹ Këtu janë përfshirë pesë grupet kryesore të konsumit (ushqimi, banimi, transporti, veshmbathjet dhe alkooli dhe duhani)

3 Të hyrat private në Kosovë 2007 - 2009

3.1. Të hyrat kryesore të ekonomive familjare

Rrogat nga sektori publik janë burimi më i rëndësishëm i të hyrave në Kosovë dhe janë burimi kryesor për një të katrën e ekonomive familjare.

Burimi tjetër më i rëndësishëm janë rrogat nga sektori privat si dhe bizneset. Pothuajse një nga dhjetë ekonomitë familjare jeton nga paratë e dërguara nga jashtë (remitenca).

Shumica e ekonomive familjare kanë burime të përziera të të hyrave, prandaj të hyrat e tanishme japin një pasqyrë të ndryshme.

Tabela 5: Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë, % e ekonomive familjare

(%)

Burimi i të hyrave	2009	2008
Rrogat dhe pagat nga sektori publik	26,0	24,7
Rrogat dhe pagat nga sektori privat	18,8	19,5
Bujqësi	6,0	7,0
Të ardhurat nga mëditjet ¹	10,2	8,1
Biznese të tjera të ekonomive familjare	12,3	14,5
Pensionet	8,2	8,1
Të hollat e dërguara nga jashtë	9,8	10,3
Të hollat e dërguara nga Kosova	0,6	1,2
Ndihma sociale ² - Kategori I	3,4	4,9
Ndihma sociale - Kategori II	2,2	-
Të tjera ³	2,4	1,7
Totali	100	100

¹ Të hyrat nga aktivitete të përkohshme.

² Ndihma sociale – në vitin 2008 nuk kemi pasur kategori të ndara.

³ Të tjera – Burimi i të hyrave jo të përcaktuara në kategoritë më lartë.

3.2 Burimet e të hyrave individuale

Burimi kryesor i të hyrave janë rrogat nga punësimi i rregullt që përbëjnë rreth gjysmën e të hyrave të përgjithshme. Rreth 7 përqind janë fituar nga puna e përkohshme.

Burim i dytë janë të hyrat neto nga bizneset që përbëjnë 14 përqind të të hyrave të përgjithshme dhe nga bujqësia 1 përqind.

Burimi tjetër i rëndësishëm janë paratë e gatshme të dërguara nga jashtë (remitenca) nga pjesëtarët e ekonomive familjare 7 përqind më një shtesë prej 5 përqind nga të tjerët jashtë vendit. Pensionet nga Kosova përbëjnë 6 përqind dhe pensionet nga jashtë 4 përqind.

Rrogat nga punësimi i rregullt janë më të rëndësishme për femrat sesa për meshkujt.

Pensionet nga Kosova përbëjnë burimin e dytë më të rëndësishëm për femrat me 14 përqind krahasuar me vetëm 4 përqind për meshkujt.

Tabela 6: Burimet e të hyrave individuale në Kosovë, viti 2009, % e të hyrave

Burimi i të hyrave	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Rrogat dhe pagesat e fituara në Kosovë, neto pa tatim	42	57	45
Pagat në natyrë	0	0	0
Të ardhurat nga mëditjet	8	1	7
Qiraja, dividendë, interesi (nga kursimi në bankë)	2	1	2
Benefitet për mirëqenie sociale	1	3	2
Pensionet nga Kosova	4	14	6
Pensionet nga jashtë Kosovës	4	3	4
Të hollat e dërguara në para të gatshme nga Kosova	0	1	1
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	16	5	14
Para të gatshme të dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(pagat, transferet, etj)	7	7	7
Para të gatshmet dërguara nga diaspora nga persona të tjera	5	5	5
Dhuratat në natyrë dërguara nga diaspora	0	0	0
Të hyrat nga bujqësia	1	1	1
Të tjera	9	0	8
Totali në %	100	100	100
Totali në milion €	1 099	252	1 352

Arsimimi ka ndikim kryesor në burimet e të hyrave. Arsimimi më i madh shpie në më shumë të ardhura nga punësimi i rregullt. Ata me shkollë fillore apo më pak, në masë të konsiderueshme duhet të jetojnë nga mëditjet, pensionet nga jashtë, biznesi vetanak dhe mbështetja nga jashtë.

Tabela 7: Burimet e të hyrave sipas nivelit më të lartë të arsimimit, viti 2009 (%)

Burimi i të ardhurave	Me arsim fillor	Me arsim të mesëm	Me uniersitet e më të lartë
Pagat nga punësimi i rregullt	22	49	82
Pagat në natyrë	0	0	0,1
Të ardhurat nga mëditjet	14	7	1
Qiraja, dividendë, interesi (nga kursimi në bankë)	2	2	2
Benefitet për mirëqenie sociale	4	1	0
Pensionet nga Kosova	6	2	2
Pensionet nga jashtë Kosovës	8	2	0
Të hollat e dërguara në para të gatshme nga Kosova	1	1	0
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	13	18	9
Para të gatshmet dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(pagat,transferet, etj)	11	6	0
Para të gatshme të dërguara nga diaspora nga persona të tjerë	9	3	2
Dhuratat në natyrë dërguara nga diaspora	-	-	-
Të hyrat nga bujqësia	1	1	
Të tjera	9	8	1
	100	100	100

3.3 Të ardhurat sipas strukturës gjinore

Femrat kanë të hyra shumë më të ulëta se meshkujt, si grup dhe si mesatare individuale. Si shpjegim mund të jetë vëllimi i ndryshëm i punëve sesa pagat e padrejta.

Prej të hyrave mesatare nga punësimi 12 mujor prej 53 përqind, meshkujt fitojnë pothuajse 27 përqind më shumë se femrat.

Tabela 8: Të ardhurat mesatare vjetore sipas gjinisë për të punësuarit me punësim 12 mujor, në €

Të ardhurat	Paga vjetore mesatare e meshkujve me punësim 12 mujor	Paga vjetore mesatare e femrave me punësim 12 mujor	Përqindja e të punësuarëve me punësim 12 mujor
Të ardhurat për punësim 12 mujor	5.465 €	4.311 €	53%
Të punësuarit me arsim fillor 12 mujor	4.888 €	2.615 €	60%
Të punësuarit me arsim të mesëm 12 mujor	5.250 €	4.290 €	53%
Të punësuarit me arsim të lartë 12 mujor	6.608 €	4.879 €	52%

4 Pronësia sipas strukturës gjinore

Sipas të dhënave të Anketës mbi buxhetin e ekonomive familjare shihet se tradita që mashkulli të jetë pronar i shtëpisë ose banesës ngadalë po transformohet. Femrat po vetëdijesohen dhe po realizojnë të drejtat e tyre.

Tabela 9: Pronësia në vitin 2009 sipas gjinisë, në %

Pronar i shtëpisë (banesës)	%
Mashkull	92
Femër	7
Bashkëpronar	1

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

64.03:31(496.51)

Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare 2009 / [përgatitur nga
Bashkim Bellaqa...et al.]. – Prishtinë : Enti i Statistikës së Kosovës,
2010. – 23 f. : ilustr. ; 29 cm. – (Seria 5 : Statistikat Sociale)

1.Bellaqa, Bashkim 2.

Parathënie / Nait Vrenezi : f. 5. – Lista e shkurtesave : f. 6

ISBN 978-9951-575-13-3

Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

Struktura organizative e ESK-së, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare. Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale. Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: Enti i Statistikës së Kosovës, Rr. "Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**
- **Telefonat:**
Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111
Drejtori: +381 (0) 38 235 545
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: social@ks-gov.net**
- **Ueb-faqe: www.ks-gov.net/esk**

ISBN 978-9951-575-13-3